



Zëri i Grave

Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

dhjetor 2012



** Gëzuar *
* Festat! **

Më 15 dhjetor, më shumë se 160 gra dhe vajza janë mbledhur në kuvendin vjetor të 10-të me radhë të anëtareve të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës.

Në këtë botim

[Delegacioni Kosovar nga Paqja dhe Siguria e Grave vizitoj Brukselin](#)

[Anëtarët e RrGGK-së u aftësuan mbi shkrimin e projekt propozimeve](#)

[Katalogu nderon Gratë në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë](#)

[QKSGJ nis fushatën kundër dhunës në baza gjinore](#)

Bashkohuni me ne!



[Bashkangjitu në faqen e Facebook-ut](#)

[Bashkangjitu në Grupin tonë në Facebook](#)



[Bashkangjitu listës së dërgesave për e-lajme](#)

Mblidhen anëtarët e RrGGK-së, festojnë kuvendin vjetor të 10-të me radhë të anëtarësimit

Rreth 160 pjesëmarrëse ishin prezente në kuvendin vjetor të 10-të të anëtarësimit të Rrjetit të Grupeve të Grave (RrGGK) më 15 dhjetor në Prishtinë, duke u bërë kuvendi vjetor i anëtarësimit me pjesëmarrje më të madhe që është mbajtur ndonjëherë nga RrGGK. Pjesëmarrëset ishin përfaqësuese të organizatave anëtare të RrGGK-së, partnerët, donatorët dhe media.

Takimi filloi me muzikë të bukur performuar nga Kori i Grave Lira, organizatë anëtare e RrGGK-së, si dhe me një poemë të shkruar dhe recituar nga aktorja dhe aktivistja Safete Rogova. Pastaj, kryetarja e Bordit të RrGGK-së, Elmaze Gashi hapi mbledhjen. Ajo lexoi letrën e saj, të botuar në Raportin Vjetor të RrGGK-së, e cila reflekton përparimin e RrGGK-së gjatë vitit 2012. Ajo theksoi se pasi që personalja është politike, lufta për arritjen e të drejtave të grave është dhe ka qenë gjithmonë politike, prandaj puna e RrGGK-së është dhe duhet të jetë poashtu edhe politike.

"Arsyeja se pse jemi këtu është për të ndihmuar organizatat të bëhen më të qëndrueshme dhe më të forta në komunitetet në të cilat ato veprojnë", tha Lina Andeer, përfaqësuese e Kvinna till Kvinna (KtK) partnere dhe përkrahëse e RrGGK-së. Për këtë qëllim, KtK ka mbështetur themelimin e Fondit të Grave të Kosovës të RrGGK-së. Ky fond i mundëson organizatave që të kenë qasje në grante të vogla, duke mbështetur punën e tyre të vështirë për forcimin e pozitës së gruas në shoqëri.

Përveç mbështetjes së vazhdueshme të KtK-së drejt Fondit të Grave të Kosovës, RrGGK kishte kënaqësinë për të mirëpritur Christian Geosits, përfaqësues i Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), i cili njoftoi fillimin zyrtar të mbështetjes së tyre dy-vjeçare për RrGGK-në.

"Jam shumë i kënaqur që të punoj për të mbledhur fonde për gratë në Kosovë", tha ai. ADA do të financojë 80.000€ në grante për anëtarët e RrGGK-së gjatë viteve 2013-2014, poashtu edhe për Grupet Avokuese për Barazi Gjinore të mbështetura nga RrGGK në 13 komunat e Kosovës.

Drejtoresha ekzekutive, Igballe Rogova, raportoi mbi punën e RrGGK-së gjatë vitit 2012 si dhe për prioritetet për vitin 2013. Anëtarët e RrGGK-së patën mundësinë që të flasin në lidhje me punën e RrGGK-së si dhe për të shkëmbyer informata në lidhje me aktivitetet e tyre gjatë vitit 2012.

"Dua të falenderoj stafin e RrGGK-së për mbështetjen që kanë dhënë në fusha të ndryshme për ne", tha Bajramshahe Jetullahu nga Komiteti i Grave të Verbëra, "duke përfshirë seminarin e fundit mbi shkrimin e propozimeve të projektit si dhe ndihma të tjera që RrGGK dhe Igballe Rogova si udhëheqëse e saj kanë dhënë për ne në mënyrë që të përmirësohet gjendja dhe pozita e grave të verbëra në Kosovë." Ajo pastaj i dha Igballe Rogovës një certifikatë të mirënjohjes.

Pas drekës, këngëtarja e njohur kosovare Rona Nishliu përformoi këngën e saj të re, "Se vetëm zemra flet saktë". Ajo e kompozoi këtë këngë për fushatën kundër dhunës "Bonu cool, mos bjer shpullë!", të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Multimedia dhe Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut.

Pas performancës, Rona ishte e para që të zgjedh një numër për lojën shpërblyese të RrGGK-së, gjatë të cilës RrGGK dha çmime për anëtarët e saj. Anëtarët që fituan ishin:

- Sadije Dulahu nga OJQ Lulishtja: një kompjuter tavoline
- Gjylfidane Morina nga OJQ Ne jemi pjesë të botës: një laptop
- Advije Gashi nga OJQ Norma: një telefon mobil
- Valire Buza nga OJQ Lira: dy CD
- Hasime Tahiri nga OJQ Mundësia: një maus për kompjuter
- Ola Sylja nga OJQ Drita e Krushës: një USB
- Mimoza Paçuku nga Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë: një USB



Lina Andeer nga KtK dhe Elmaze Gashi, Kryetare e Bordit të RrGGK dëgjojnë derisa Christian Geosits nga ADA shpall mbështetjen për RrGGK, anëtarët.

RrGGK dha mirënjohje për tre aktivistet e shquara nga rajoni: Delina Fico nga Shqipëria, si një frymëzim dhe mbështetëse e vazhdueshme e rrjetit; Lepa Mlladenović nga Serbia si një motër feministe përtej kufijve dhe Dr. Zylfie Gjoni Duraku, Drejtoreshë e organizatës Anima nga Ulqini, Mali i Zi për punën e saj si një aktiviste për të drejtat e grave dhe vajzave.

Së fundi, anëtarët e RrGGK-së zgjodhën katër anëtare të reja të Bordit: Elmaze Gashi, Ariana Qosaj-Mustafa, Nermin Mahmutaj dhe Ola Syla. Në fund të ditës, anëtarët e RrGGK-së gjithashtu paraqitën vlerësimet e tyre për RrGGK-në dhe punën e saj në vitin 2012, së bashku me dy anketa për organizatat e tyre dhe hapat e ardhshëm respektivisht pas Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Takimi përfundoi me një tortë të madhe të dekoruar me fishekzjarre, duke festuar kuvendin vjetor të 10-të të anëtarësimit të RrGGK-së. Anëtarët kishin mundësinë për rrjetizim, të shkëmbejnë dhe të diskutojnë përvojat e tyre.

Delegacioni Kosovar nga Paqja dhe Siguria e Grave vizitoj Brukselin

Delegacioni i eksperteve nga Paqja dhe Siguria e Grave nga Kosova vizituan Brukselin në nëntor të vitit 2012. Delegacioni përfshiu Suzana Novobërdaliu, anëtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryetare e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Edona Hajrullahu, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit ministrit; Elmina Mahmuti, komandante rajonale e Policisë së Kosovës në Gjilan, dhe Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK-së. Vizita e avokimit u organizua nga UN Women, Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. Vizita përfshiu takime me institucione të ndryshme Evropiane.

Gjatë një takimi me një delegacion nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin në Komisionin Evropian, gratë kosovare ngritën këto çështje: përfshirjen e një pjese të veçantë të përqëndruar mbi barazinë gjinore në kuadër të raportit të progresit vjetor të Kosovës; përfshirjen e brengave të grave lidhur me drejtësinë tranzicionale në dialogun politik Prishtinë - Beograd; liberalizimi i vizave; qasje më të madhe në fonde për grupe të grave, përmes skemave të mikro-granteve; dhe ngritja e kapaciteteve për shoqërinë civile dhe zyrtarët e qeverisë, në mënyrë që ato të mund të aplikojnë në fondet IPA.

Në takim me një anëtare të Parlamentit Evropian Marije Cornelissen, ekspertet kosovare diskutuan raportin e saj, duke përfshirë rolin e EOU në lidhje me barazinë gjinore; rolin e shoqërisë civile si dhe bashkëpunimin me qeverinë; si dhe sfidat në zbatimin e ligjeve ekzistuese të Kosovës. Ato paraqitën edhe sfidat kryesore që gratë ballafaqohen, të tilla si: pronësia; pjesëmarrja e ulët në vendim-marrje; si dhe statusi i pazgjithur i të mbijetuarëve të konfliktit, duke përfshirë ato nga dhuna seksuale.

Ekspertet kosovare u takuan gjithashtu me Shërbimin e Punëve të Jashtme Evropiane (EEAS), ku ato theksuan nevojën për ti përfshirë gratë dhe shqetësimet e grave në dialogun politik mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur gjatë dialogut. Delegacioni i Kosovës bëri thirrje gjithashtu për krijimin e një instrumenti që e detyron Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian (EUSR) në Kosovë që rregullisht të konsultohet me advokatët gjinorë. Gjatë këtij takimi janë bërë sugjerime për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), duke përfshirë që EULEX-i të ketë një qasje më të kuptueshme dhe transparente dhe të merret më shumë me rastet penale që lidhen me të mbijetuarat e dhunës seksuale.

Ekspertet kosovare pastaj u takuan me përfaqësuesit nga Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), duke përfshirë Mari Skåre, Përfaqësuesen Speciale të Sekretarit të Përgjithshëm për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Përveç dëgjimit të përvojave me integrimin gjinor brenda NATO-s, ekspertet kosovare adresuan shqetësimet e tyre në lidhje me sigurinë në veri të Mitrovicës, ku KFOR-i ka një mandat ende relativisht të gjërë. Ato kërkuan mbështetje të vazhdueshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, pasi që KFOR-i ka një mandat përtej kufijve.

Së fundi, gjatë një takimi me Zyrën Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtim të Paqes (EPLO), ekspertet kosovare diskutuan Planin e Veprimit për Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325 që është duke u hartuar në Kosovë; mundësia e zgjerimit të EPLO-së si dhe përfshirja e më shumë organizatave të Kosovës; shkëmbimit të përvojave me organizatat anëtare të EPLO-së; si dhe mundësinë e organizimit të një drekte pune në EPLO lidhur me dialogun politik mes Prishtinës dhe Beogradit dhe/apo udhëheqësinë e grave në Kosovë.

Anëtarët e RrGGK-së u aftësuan mbi shkrimin e projekt propozimeve

Që nga fillimi i RrGGK-së, anëtarët kanë kërkuar një punëtori mbi hartimin e projekteve. Në përgjigje të kërkesave të anëtareve, RrGGK organizoi dy punëtori të tilla në Prishtinë më 6-7 dhe 10-11 dhjetor 2012.

"Ne me të vërtetë kemi nevojë për punëtori si ajo mbi hartimin e projekteve", tha Bahrije Deva nga Shoqata për Arsimit dhe Kujdes të Familjes në Gjakovë, një organizatë anëtare e RrGGK-së.

Punëtoritë interaktive dy-ditore mbuluan bazat mbi hartimin e propozimit të projektit, duke përfshirë edhe përmbajtjen e propozimit të projektit, manaxhimin e bazuar në rezultate, analizimin e palëve të interesuara, analizimin e problemit dhe trungun e problemeve si dhe hierarkia e objektivave brenda një kornize logjike. Më shumë se 50 pjesëmarrëse u aftësuan në hartimin e propozimeve për projekte.

"Edhe pse kam mjaft përvojë në sektorin e OJQ-ve, kur shkruaj projekt-propozime gjithmonë i përziej qëllimet dhe objektivat. Pas kësaj punëtorie, mund ti dalloj ato dhe tregoj se cila është cila", tha Ola Syla nga Shoqata Grave Drita e Krushës, një orgnizatë tjetër anëtare e RrGGK-së.

Punëtoriu u drejtua nga anëtarët e stafit të RrGGK-së që posedojnë përvojë dhe ekspertizë në shkrimin e propozimeve: Nicole Farnsworth, Albertina Binaku dhe Zana Rudi.



Këngëtarja Rona Nishliu asiston në tërheqjen e numrave, duke shpërblyer Advije Gashi-n nga Norma me një telefon.



Anëtarët e RrGGK marrin pjesë në një punëtori interaktive dy ditore mbi shkrimin e projekt propozimit.

"Kjo punëtori më ka ndihmuar shumë poashtu edhe koleget e mia, ka qenë i pari i këtij lloji për ne", tha Kadrije Tahiraj nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Drenas. "Ne e vlerësojmë shumë si dhe faktin që RrGGK organizoj atë pa pagesë për ne. Ne e dimë se në vende të tjera në botë, për punëtori të tilla duhet të paguhet për pjesëmarrje."


Përveç ofrimit falas të mentorimit në vazhdimësi gjatë shkrimit të projekteve të tyre në të ardhmën, RrGGK planifikon të ofroj edhe punëtori në vazhdimësi mbi analizimin e riskut, monitorimin dhe vlerësimin, të gjitha këto gjatë vitit 2013.

Në bazë të kërkesave të anëtareve, RrGGK gjithashtu ka organizuar një punëtori një-ditore mbi buxhetimin dhe menaxhimin financiar, më 20 dhjetor. Menaxherja e financave e RrGGK-së, Besa Shehu e drejtoj punëtorinë, ku përfshinte planifikimin e buxhetit për projektet, menaxhimin financiar, kontrollet, raportimin, formulat në Excel, si dhe llogaritjen e pagave, duke përfshirë tatimin dhe kontributet pensionale.

Bazuar në kërkesat e anëtareve, RrGGK do të ofrojë mundësi shtesë për ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e saj në vitin 2013. Këto shërbime janë ofruar për anëtarët e RrGGK-së, si pjesë e programit të ngritjes së kapaciteteve të RrGGK-së, financuar nga Kvinna till Kvinna.

Katalogu nderon Gratë në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë

Në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, autorët Gjylshen Berisha, Hanëmshahe Ilazi dhe Sanie Zeqiraj publikuan një katalog të titulluar Nderim Gruas.



"Për gratë trime të kombit të cilat nuk janë përmendur me lapsin e kronikës apo vargjet e rapsodisë, e as në përgdheljet e përrallave", shkroi Hanëmshahe Ilazi në hyrje. "Shumë gra shqiptare që vepruan për çështje kombëtare përgjatë shekujve së bashku me burrat kanë mbetur anonime", shtoi Znj. Ilazi.

Libri i tyre synon të sjellë gratë në historinë shqiptare me katalogimin e grave nga periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga fillimi i shekullit të 20-të. Gratë në libër vijnë nga sfera të ndryshme të jetës, duke përfshirë shkollat shqipe, humanitarizmi, politika, shoqëria civile, arti, teatëri, muzika dhe filmi.

"Le të jetë ky katalog ofertë mirëbërëse në këtë përvjetor të veçantë për të gjitha ato gra që kanë punuar dhe kontribuar direkt ose indirekt drejt pavarësisë, lirisë, demokracisë dhe ndërtimit të shtetit", tha Gjylshen Berisha, një nga autorët.

Benefactor (Mirëbërja), një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2007, botoj katalogun. Benefactor (Mirëbërja) synon të përmirësojë jetën e të gjithë njerëzve përmes artit dhe kulturës, veçanërisht të gjeneratave më të vjetra.

QKSGJ nis fushatën kundër dhunës në baza gjinore

"Bonu cool, mos bjer shpullë" është sllogani i fushatës së nisur kohët e fundit kundër dhunës me bazë gjinore në mesin e adoleshentëve. Fushata është pjesë e një projekti të financuar nga BE implementuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Multimedia dhe Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut (YIHR).

Rona Nishliu, këngëtare e njohur nga Kosova, e kompozoi këtë këngë për fushatën dhe e titulloj "Se vetëm zemra flet saktë". Ajo e këndoj këtë këngë në kuvendin vjetor të antarësimit të RrGGK-së.

Fushata e financuar nga BE, e udhëhequr nga QKSGJ përfshinë edhe materiale të tjera për marrëdhënie me publikun si dhe përpjekje të tjera për komunikim që ka për synim të arrijë tek të rinjtë.

